URDHËR
Nr. 140, datë 1.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 22, pika 3, 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, znj. Ermelinda Durmishi, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Programimit Strategjik në këtë Agjenci.
2. Delegimi i kompetencave fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri deri në plotësimin e pozicionit të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.
3. Ngarkohet znj. Ermelinda Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama